

JANAR - TETOR 2020

RAPORTI I MONITORIMIT TË NARIC KOSOVA

2



RAPORTI I MONITORIMIT TË NARIC KOSOVA 2

JANAR - TETOR 2020

Publikues:

ORCA - Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim

www.orca-ks.org

info@orca-ks.org

Simon Shiroka, H-11, Nr. 8

Prishtina, 10000, Kosova

Autorë:

Liridona Ademaj

Skord Retkoceri

Prishtinë, nëntor 2020



“Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë
gojën mbyllur kur s’kemi gjë për të thënë.
Falna durimin të thellojmë një punë përpara
se të shkruajmë mbi të! Frymëzona me një
ndjenjë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo
vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu!
Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga
shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e
shtypit. Ashtu qoftë!”

[Faik Konica]

TABELA E PËRMBAJTJES

Definime.....	8
Listë e shkurtesave.....	9
Hyrje.....	10
Legjislacioni dhe procedurat e njohjes	11
Vendimet e NARIC Kosova	12
Sfidat e Qendrës NARIC Kosova	18

DEFINIME

- **Njohje** - do të thotë një pranim zyrtar nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në Kosovë (MASH), i një diplome të fituar jashtë vendit, e cila e konfirmon saktësinë dhe vërtetësinë e saj.
- **Barasvlerë** - do të thotë një pranim zyrtar nga ana e MASH-it i një diplome të fituar jashtë vendit, e cila e konfirmon saktësinë dhe vërtetësinë e saj dhe bën krahasimin me nivelin e diplomave dhe fushës studimore përkatëse në vend.
- **Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (NARIC - National Academic Recognition and Information Center)** - përbëhet nga Zyra e Qendrës dhe Këshilli Shtetëror për Njohje dhe ofron informacion në procedurat për njohjen e diplomave dhe kualifikimeve të huaja, si dhe ofron informata për sistemin e arsimit të lartë dhe kualifikimet në Kosovë me kërkesë të shteteve të tjera.
- **Këshilli Shtetëror për Njohje (KShNJ)** - është organ i cili merr vendime për njohje/ barasvlerë apo mosnjohje/mosbarasvlerë, duke u bazuar në dosjen e parashtruesit të kërkesës dhe raportin e përgatitur nga zyrtari i Qendrës dhe në raste të veçanta, bazuar në rekomandimin e komisionit të ekspertëve. Përbëhet nga profesorë universitar të fushave të ndryshme studimore.

LISTË E SHKURTESAVE

- **MASH** - Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Kosovë
- **NARIC KOSOVA** - Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik
- **KShNj** - Këshilli Shtetëror për Njohje
- **MASR** - Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Shqipëri
- **Niveli 5** - Shkollë e lartë profesionale
- **BA** - Studimet themelore Baçelor i Arteve
- **MA** - Studimet Master i Arteve
- **PhD** - Studimet e doktoratës
- **ORCA** - Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim

HYRJE

Procesi problematik i njohjes së diplomave të fituara jashtë vendit, i cili shpeshherë ka qenë edhe temë diskutimi në vendin tonë, ka shtyrë ORCA-n që të vazhdojë me monitorimin e Qendrës Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (NARIC Kosova).

Ky raport është rezultat i monitorimit të punës së Këshillit Shtetëror për Njohje (KShNj) në kuadër të qendrës NARIC Kosova, për periudhën janar-tetor të vitit 2020.

ORCA ka qenë e pranishme në mbledhjet e mbajtura nga KShNj, si dhe ka mbajtur takime të vazhdueshme me stafin e Zyrës së Qendrës NARIC, bashkë me të cilët edhe janë listuar sfidat me të cilat po përballen gjatë kohës së realizimit të punës së tyre.

Mungesa e një ligji të veçantë, stafi i vogël në numër, mungesa e rregullores së punës së KShNj-së, diplomatë e fituara në shtete të huaja të cilat për arsye të ndryshme mbesin në proces apo nuk arrihet t'u jepet njohje, mungesa e një databaze online, janë vetëm disa prej problemeve të cilat po e vështirësojnë funksionimin efikas të kësaj qendre.

Të njëjtin hulumtim ORCA e ka kryer edhe në shkurt të vitit 2020¹, në të cilin ishin mbledhur të dhëna për periudhën prill-dhjetor të vitit 2019.

¹ "Raporti i monitorimit të NARIC KOSOVA", shkurt 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2017/02/RAPORTI-I-MONITORIMIT-T%C3%8B-NARIC-KOSOVA-ALB-03.pdf>

LEGJISLACIONI DHE PROCEDURAT E NJOHJES

Puna e Qendrës NARIC Kosova është e rregulluar me legjislacionin në fuqi si më poshtë:

- 1 Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës²
- 2 Udhëzimin Administrativ për verifikimin e dokumentacionit shkollor (Publik dhe privat) për nevojat e kandidatëve që shkollohen jashtë shtetit³,
- 3 Udhëzimin Administrativ për Parimet dhe Procedurat e Njohjes së Diplomave, Gradave dhe Kualifikimeve të Shkollave të Larta Profesionale dhe Universitare të Fituara Jashtë Republikës së Kosovës⁴.

Lëndët apo diplomat e universiteteve publike të rajonit dhe universiteteve në listat e rangimeve botërore në Academic Ranking of World Universities (ARWU), Times Higher Education World University Ranking (THE) dhe QS World University Ranking, pasi marrin konfirmimin nga shteti se janë autentike dhe të vlefshme, miratohen nga stafi i Zyrës së Qendrës NARIC.

Këshilli Shtetëror për Njohje, shqyrton vetëm lëndët për të cilat stafi i Qendrës NARIC konstaton se duhet një ekspertizë më e thellë.

Detaje të procedurave për njohje, mund të gjenden në Raportin e Monitorimit të NARIC Kosova të publikuar nga ORCA në shkurt të vitit 2020.⁵

² Ligji për Arsimin e Lartë, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2761>

³ Udhëzimi Administrativ për Verifikimin e Dokumentacionit Shkollor (Publik dhe privat) për Nevojat e Kandidatëve që Shkollohen Jashtë Shtetit, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10210>

⁴ Udhëzimi administrative për Parimet dhe Procedurat e Njohjes së Diplomave, Gradave dhe Kualifikimeve të Shkollave të Larta Profesionale dhe Universitare të Fituara Jashtë Republikës së Kosovës, linku <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15228>

⁵ “Raporti i monitorimit të NARIC KOSOVA”, shkurt 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2017/02/RAPORTI-I-MONITORIMIT-T%C3%8B-NARIC-KOSOVA-ALB-03.pdf>

VENDIMET E NARIC KOSOVA

Në periudhën kohore janar-tetor të vitit 2020, janë marrë gjithsej 663 vendime nga Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (NARIC Kosova), ndërkohë që në proces, janë 194 lëndë apo diploma të cilave nuk u është dhënë përgjigje nga institucionet ku palët i kanë përfunduar studimet, apo nga qendrat NARIC të shteteve përkatëse.

Vendimet e Këshillit Shtetëror për Njohje (KShNj)

Gjatë kësaj periudhe, Këshilli Shtetëror për Njohje (KShNj) ka mbajtur gjithsej tetë mbledhje në datat 22 janar, 19 shkurt, 11 mars, 26 maj, 5 gusht, 9 shtator, 10 tetor dhe 22 tetor ku janë marrë vendime për njohje të diplomave.

Pjesë e këtyre vendimeve, janë diplomat e fituara në institucione të arsimit të lartë publik dhe privat.

Në mbledhjen e mbajtur më 22 janar, KShNj ka njohur 25 diploma të nivelit Bachelor, 7 të nivelit Master dhe 10 për nivelin doktoratë, e që gjithsej janë 42 diploma të njohura.

Në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt, KShNj ka dhënë vendim pozitiv për një diplomë të nivelit të pestë, 20 diploma të nivelit Bachelor, 12 të nivelit Master dhe 13 të nivelit doktoratë, e që gjithsej janë 46 diploma të njohura.

Në mbledhjen e mbajtur më 11 mars, KShNj ka njohur një diplomë të nivelit të pestë, 14 diploma të nivelit Bachelor të studimeve, ndërkohë që nuk e ka njohur një diplomë të këtij niveli, tutje ky këshill ka dhënë vendim pozitiv edhe për 7 diploma të nivelit Master dhe për 9 të doktoratës, e që në total i bie se janë njohur 31 diploma.

Në mbledhjen e mbajtur më 26 maj, KShNj ka dhënë vendim pozitiv për 4 diploma të nivelit të pestë, 43 diploma të nivelit Bachelor, 32 të nivelit Master dhe 21 të nivelit doktoratë, pra gjithsej kanë njohur 100 diploma.

Në mbledhjen e mbajtur më 5 gusht, KShNj e ka njohur një diplomë të nivelit të pestë, 36 të nivelit Bachelor, 20 të tjera të nivelit Master dhe 23 të nivelit doktoratë, e që në total i bie se është marrë vendim për 80 lëndë.

Në mbledhjen e mbajtur më 9 shtator, KShNj ka miratuar kalimin e një diplome të nivelit të pestë, 7 diplomave të nivelit Bachelor, 15 të nivelit Master dhe 14 të nivelit të doktoratës, pra janë njohur gjithsej 37 diploma.

Në mbledhjen e mbajtur më 10 tetor, KShNj ka njohur tri diploma të nivelit Bachelor, 8 të tjera të nivelit Master dhe 9 të nivelit doktoratë, e që në total i bie se është marrë vendim për 20 lëndë.

Në mbledhjen e mbajtur më 22 tetor, KShNj ka njohur 5 diploma të nivelit Bachelor, 8 të nivelit Master dhe 5 për nivelin doktoratë, e që gjithsej janë 18 diploma të njohura.

Gjithsej KShNj ka marrë vendime pozitive për 374 lëndë, 8 të nivelit të pestë, 153 të nivelit Bachelor, 109 të nivelit Master dhe 104 të nivelit të doktoratës. Vendim negativ ka dhënë për një lëndë të nivelit Bachelor.


Vendimet nga stafi i Zyrës së Qendrës

Sa i përket numrit të lëndëve apo diplomave të vlerësuara nga Zyra e Qendrës NARIC dhe jo nga Këshilli Shtetëror për Njohje (KShNj), për diplomat e fituara në universitete botërore dhe rajonale, vetëm gjatë periudhës janar-tetor të vitit 2020, numri i përgjithshëm arrin në 288.

Prej tyre, një diplomë është miratuar nga niveli i pestë, 97 diploma janë miratuar nga niveli Bachelor, 114 nga niveli Master dhe 76 nga niveli i doktoratës.

Lëndë në listat e rangimeve botërore, si dhe ato publike të rajonit, të miratuara nga stafi i Qendrës NARIC Kosova në periudhën janar-tetor 2020

MUAJT JANAR - TETOR



Të gjitha vendimet e Qendrës NARIC Kosova

Numri i përgjithshëm i diplomave të njohura për periudhën janar-tetor të vitit 2020, është 663. Vetëm një diplomë është refuzuar në këtë periudhë.


Nga niveli i pestë janë miratuar nëntë diploma. Nga niveli Bachelor janë miratuar 250 diploma, ndërsa është refuzuar një e tillë.

Në nivelin Master janë miratuar gjithsej 223 diploma, ndërsa në nivelin e doktoratës, janë miratuar 180 diploma nga NARIC Kosova.



Vendimet për njohje të diplomave në vitin 2020 nga qendra NARIC

MUAJT JANAR - TETOR



Lëndët ende pa përgjigje


Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (NARIC Kosova), ka gjithsej 194 diploma apo lëndë të cilat ende gjenden në proces.

Numri i diplomave që janë lënë pa përgjigje dhe vijnë nga shteti i Shqipërisë është 68, nga shteti i Maqedonisë së Veriut janë 47 diploma, ndërkaq numri i përgjithshëm i lëndëve pa përgjigje nga vendet e tjera është 79.

Arsyet për mospërgjigje janë të ndryshme:

- Nuk ka përgjigje nga institucionet, ku aplikantët i kanë përfunduar studimet
- Nuk ka informacion lidhur me akreditimin dhe NARIC Kosova është në pritje të përgjigjes për akreditim
- Diplomat vijnë nga institucione të disa shteteve që nuk e njohin Kosovën si shtet
- Vonesat në përgjigje nga institucionet e Turqisë
- Përgjigje të paqarta nga institucionet e Shqipërisë

Lëndët e pranura në vazhdimësi, të cilat janë në proces dhe nuk u është dhënë përgjigje



Pasqyrë e vendimeve të Këshillit Shtetëror për Njohje dhe stafit të NARIC Kosova

		NGA KËSHILLI SHTETËROR PËR NJOHJE										NGA STAFI I NARIC
	Janar	Shkurt	Mars	Maj	Gusht	Shtator	Tetor	Janar - Tetor				
	Pozitiv	Pozitiv	Pozitiv	Negativ	Pozitiv	Pozitiv	Pozitiv	Pozitiv	Pozitiv	Pozitiv		
Niveli 5	0	1	1	0	4	1	1	0	1	1		
BA	25	20	14	1	43	36	7	8	97			
MA	7	12	7	0	32	20	15	16	114			
PhD	10	13	9	0	21	23	14	14	76			
Total	42	46	31	1	100	80	37	38	288			
Total	663											

SFIDAT E QENDRËS NARIC KOSOVA

Databaza online

Që nga shtatori i vitit 2018, NARIC-u është duke funksionuar pa një databazë online, e cila përmban të dhëna për të gjitha lëndët që kanë pranuar, ato të cilat janë në proces dhe për ato që i kanë shqyrtuar. Zyrtarët në NARIC detyrohen që për çfarëdo informacioni, kërkimin ta bëjnë në mënyrë fizike mes dokumenteve në arkiv. Andaj, propozohet krijimi i një databaze digjitale, e cila do të mundësonte ruajtjen/arkivimin e të dhënave për njohjet/barasvlerën e diplomave ndër vite.

Databaza interaktive

Përgatitja e një dokumenti/databaze për sistemin e arsimit parauniversitar dhe të lartë në Kosovë, e cila aktualisht mungon. Kjo lloj databaze do të publikohej në ueb të NARIC-ut dhe do të shërbente për shtetet e tjera, të cilat kanë nevojë për informata rreth sistemit të arsimit në Kosovë. Kjo gjithashtu do t'ua lehtësonte procedurat studentëve kosovarë të cilët për arsye të ndryshme, i përdorin diplomat e tyre jashtë shtetit.

Stafi i pamjaftueshëm

Mungesa e stafit apo kapaciteteve njerëzore, ia pamundëson NARIC-ut ndjekjen apo shqyrtimin e rasteve me kohë, për shkak të vëllimit të madh të lëndëve. Andaj propozohet që për këtë qendër, të ketë mbështetje edhe me staf profesional për kohë të caktuar (angazhimi i ndonjë eksperti me përvojë relevante); Të zhvillohet komponenti i informimit akademik përmes trajnimeve.

Mungesa e rregullores për Këshillin Shtetëror për Njohje

Krijimi i një rregulloreje për punën e Këshillit Shtetëror për Njohje (KShNj), do të mundëson-te përcaktimin e punës së këtij këshilli, siç janë: thirrja e mbledhjes, mbajtja, mënyra e vendosjes apo votimit për lëndë, zbatimimi i vendimeve dhe çështje të tjera.

Lëndët pezull nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri

Sfidë e qendrës NARIC KOSOVA vazhdon të mbetet njohja e diplomave nga shteti i Shqipërisë. Përgjigjet kontradiktore për diplomat e fituara në universitetet private të Shqipërisë, ose ndryshimi i përgjigjes nga negative në pozitive pa ndonjë arsytim të bazuar, vazhdon t’ia vështirësojë KShNj-së punën për njohje të atyre diplomave.

Në rastet kur diploma i plotëson të gjitha kushtet për njohje sipas legjislacionit në fuqi, në njërin nga rubrikat e dokumentit të dorëzuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Shqipëri(MASR) shënohet *“Kjo diplomë është e vlefshme në Republikën e Shqipërisë”*, ndërkaq sipas NARIC-ut, Shqipëria ka ndryshuar formën njëanshëm, në të cilën tashmë po shënohet *“Kjo diplomë është e vlefshme në Republikën e Shqipërisë”*, si dhe është shtuar rubrika *“Vërejtje”*, në të cilën shkruhet *“MASR nuk është përgjegjëse për vërtetësinë e të dhënave të shënuara në formular”*. Sipas NARIC-ut, ka raste për të cilat Ministria e Arsimit në Shqipëri, ka dhënë përgjigje negative dhe pas një viti ka ndryshuar përgjigjen në pozitive për njohje të diplomës.

Mungesa e një ligji të veçantë për NARIC

Propozimi për krijimin e një ligji të veçantë që e rregullon punën në NARIC, ka qenë pjesë e sfidave të NARIC-ut edhe në raportin e kaluar⁶ të publikuar nga ORCA dhe kjo për arsye se tashmë ka rast në të cilin Gjykata ka obliguar Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH), konkretisht Këshillin Shtetëror për Njohje (KShNj), që të zbatojë vendimin e saj (Gjykatës) për njohjen e diplomës së doktoratës të një kandidati. Rast ky i cili ka krijuar precedent për njohje të shtatë diplomave të tjera të doktoratës.

⁶ Raporti i monitorimit të NARIC KOSOVA”, shkurt 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2017/02/RAPORTI-I-MONITORIMIT-T%C3%8B-NARIC-KOSOVA-ALB-03.pdf>

Kronologji e vendimeve gjyqësore

- 1 Në prill të vitit 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë, kishte nxjerrë një aktgjykim përmes të cilit aprovohej si e bazuar padia e kandidatit Fisnik Bytyqi të cilit nuk i ishte njohur grada e studimeve të doktoratës “Doktor i Administrimit të Biznesit”, të fituar në Swiss Management Center⁷ (SMC) në Zvicër, dhe çështja i kthehej në rishqyrtim Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, konkretisht Këshillit Shtetëror për Njohje.

Aktgjykimi ishte nxjerrë në mungesë të palës së paditur, gjegjësisht Ministrisë së Arsimit e cila në gjykatë përfaqësohet nga Avokatura Shtetërore-Ministria e Drejtësisë.

Në arsyetimin e aktgjykimit thuhet se, është shkelur parimi i dyshkallshmërisë, në këshillën juridike është udhëzuar që ankesa të paraqitet në Këshillin e Ankesave në MASHT, por ankesën e tij në vend të Komisionit të Ankesave e ka trajtuar kryetari i Këshillit Shtetëror për Njohje, i cili ishte organ i njëjtë që e kishte marrë vendimin e shkallës së parë.

Në mars të vitit 2019, bazuar në ankesën e Ministrisë së Arsimit, Gjykata e Apelit kishte nxjerrë aktgjykim përmes të cilit e miratonte si të bazuar ankesën e MASHT-it dhe hidhte poshtë vendimin paraprak duke e kthyer lëndën në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

Në arsyetim të vendimit, mes tjerash thuhet se Ministria e Arsimit-KShNj, ka pyetur në ENIC/NARIC të shtetit të Zvicrës, Francës, Gjermanisë dhe Anglisë, e të cilat kanë theksuar se institucioni SMC nuk njihet në këto shtete.

Në maj të vitit 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë, kishte nxjerrë një aktgjykim përmes të cilit aprovohej si e bazuar padia e kandidatit Fisnik Bytyqi, dhe detyrohej Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, konkretisht Këshilli Shtetëror për Njohje, që t’ia njihte kandidatit gradën e studimeve të doktoratës “Doktor i Administrimit të Biznesit” të fituar në Swiss Management Center (SMC) në Zvicër.

Aktgjykimi ishte nxjerrë në mungesë të palës së paditur, gjegjësisht Ministrisë së Arsimit e cila në gjykatë përfaqësohet nga Avokatura Shtetërore-Ministria e Drejtësisë.

⁷ Faqja zyrtare e SMC, linku: <https://www.smcuniversity.com/about/about-smc/>

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, mes tjerash thuhej se institucioni prej të cilit kandidati kishte marrë diplomë, kishte programe të akredituara në Këshillin e Akreditimit për Arsimin e Lartë (CHEA⁸), i cili është organ akreditues i kolegjeve dhe universiteteve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe i cili njihet edhe nga Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës⁹, konkretisht me Nenin 3, paragrafi 1.16, përmes të cilit thuhet se *“Organ akreditues i njohur - Agjencia Kosovare e Akreditimit apo ndonjë organ i ngjashëm i tillë, i cili në Zonën evropiane të arsimit të lartë, është aktualisht i anëtarësuar në rrjetin evropian për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë /ENQA/, ose (në Shtetet e Bashkuara), është një organ akreditues i cili është i njohur nga Këshilli i akreditimit për arsimin e lartë /CHEA/ apo nga Departamenti i Arsimit i Shteteve të Bashkuara /USDE/ apo nga të dyja, ose (në cilindo juridiksion tjetër) është pranuar nga Ministria në baza të ndërsjella si një organ i themeluar në mënyrë të duhur shtetëror a rajonal i akreditimit, që njihet dhe është i autorizuar nga ministria relevante në kuadër të atij juridiksioni.”*

Rreth këtij vendimi, Ministria e Arsimit-KShNj ishte ankuar, ndërkohë që në nëntor të vitit 2019, Gjykata e Apelit kishte nxjerrë aktgjykim përmes të cilit e refuzonte si të pabazuar ankesën e Ministrisë së Arsimit dhe e vërtetonte aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë të marrë në maj të vitit 2019.

Në arsyetim të aktgjykimit, thuhet se ankesa konsiderohet si e pabazuar duke marrë parasysh provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës të cilat i japin të drejtë kandidatit që e ka paditur Ministrinë e Arsimit-KShNj.

Në mars të vitit 2020, Gjykata Supreme e kishte refuzuar kërkesën e Ministrisë së Arsimit, për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësorë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të datës 5 nëntor 2019.

Në arsyetim të aktgjykimit thuhet se kërkesa e Ministrisë së Arsimit është e pabazuar sepse nuk janë gjetur dëshmi për vërtetim të kundërt të gjendjes faktike prej asaj që ishte vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë.

⁸ Faqja zyrtare e Këshillit të Akreditimit për Arsimin e Lartë, linku: <https://www.chea.org/>

⁹ Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2761>

- 2 Rast tjetër i padisë për mosnjohje të diplomës së fituar është edhe ai i kandidatit Emrush Thaçi, i cili në vitin 2016 kishte marr vendim negativ nga Këshilli Shtetëror për Njohje, sa i përket njohjes së gradës së doktoratës, “Doktor i Filozofisë në Psikologji”, e fituar në “Inter-regional Academy of Personnel Management” në vitin 2014.

Njohja ishte refuzuar nga KShNj, si pasojë e mungesës së akreditimit të programit në kohën kur kandidati i kishte kryer studimet.

Në tetor të vitit 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë, kishte nxjerrë një aktvendim përmes të cilit thuhej se aprovohej si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Emrush Thaçi dhe se anulohet vendimi i vitit 2016, i të paditurës, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe se çështja i kthehej të paditurës në rishqyrtim dhe rivendosje.

Në arsyetim të aktgjyqimit thuhej se pala e paditur, gjegjësisht Ministria e Arsimit e cila në gjykatë përfaqësohet nga Avokatura Shtetërore-Ministria e Drejtësisë, kishte munguar në seancën e shqyrtimit kryesor dhe se mungesën nuk e kishte arsyetuar.

Dhe se vendimi i nxjerrë nga ana e Ministrisë së Arsimit, ishte i mangët andaj edhe nuk mund të shqyrtohej ligjshmëria e tij. Pra, sipas gjykatës, në vendimin e KShNj-së mungonte arsyetimi i qartë, sqarimi i bazës ligjore dhe faktike, andaj edhe vendimi i kundërshtuar nga ana e MASH, konsiderohej juridikisht i paqartë dhe kundërthënës meqenëse në arsyetim nuk kishin dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit apo pa e theksuar konkretisht se cilat dëshmi janë marrë për bazë.

Pas kthimit në rishqyrtim në Ministri të Arsimit, KShNj kishte kontaktuar me institucionin në të cilin kandidati i kishte kryer studimet dhe me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës në Ukrainë, gjegjësisht me zyrën ENIC/NARIC në Ukrainë.

Përgjigja e Akademisë ishte se kandidati Emrush Thaçi ka kryer studimet e doktoratës në atë institucion dhe se certifikata e akreditimit të programit ishte valide dhe e njohur nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Ukrainë.

Mirëpo, përgjigje tjetër është dhënë nga ENIC/NARIC në Ukrainë, të cilët kishin theksuar se kjo diplomë nuk njihet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Ukrainë dhe se institucioni “Inter-regional Academy of Personnel Management” në vitin 2014, nuk kishte statusin relevant të akreditimit për të dhënë diploma të doktoratës.

Me përgjigjen zyrtare të zyrës ENIC në Ukrainë, KShNj, qëndron prapa vendimit negativ, i cili ishte dhënë për kandidatin në fjalë në vitin 2016.

Njohja e tetë (8) diplomave bazuar në vendim gjyqësor

Sipas vendimit të fundit të Gjykatës, shkalla e dytë e Apelit, si dhe asaj Supreme, Këshilli Shtetëror për Njohje në kuadër të Qendrës Kombëtare për Njohje të Diplomave (NAIRC KOSOVA), përveç kandidatit që ka ushtruar padinë, në bazë të precedentit të krijuar të bazuar në legjislacionin përkatës ua ka njohur gradën e doktoratës edhe shtatë personave të tjerë si më poshtë:

- 1 Fisnik Bytyqi, i është njohur grada shkencore “Doktor në Administrim Biznesi”, e fituar në “Swiss Management Center (SMC)” në Zvicër.
- 2 Blerim Pushkolli, i është njohur grada shkencore “Doktor në Financa”, e fituar në “Swiss Management Center (SMC)” në Zvicër
- 3 Valon Murtezaj, i është njohur grada shkencore “Doktor i Diplomacisë”, e fituar në “Swiss Management Center (SMC)” në Zvicër.
- 4 Bashkim Isufi, i është njohur grada shkencore “Doktor në Administrim Biznesi”, e fituar në “Swiss Management Center (SMC)” në Zvicër.
- 5 Besnik Skenderi, i është njohur grada shkencore “Doktor në Menaxhment”, e fituar në “Swiss Management Center (SMC)” në Zvicër.
- 6 Nazmi Zeqiri, i është njohur grada shkencore “Doktor në Administrim Biznesi”, e fituar në “Swiss Management Center (SMC)” në Zvicër.
- 7 Arton Celina, i është njohur grada shkencore “Doktor në Administrim Biznesi”, e fituar në “Swiss Management Center (SMC)” në Zvicër.
- 8 Faruk Ahmeti, i është njohur grada shkencore “Doktor në Administrim Biznesi”, e fituar në “Swiss Management Center (SMC)” në Zvicër.

KShNj, sipas legjislacionit në fuqi, e ka zbatuar vendimin e gjykatës për njohje të diplomave të fituara në SMC në Zvicër dhe mbi bazë të precedentit të krijuar është vërtetuar njohja për të gjithë aplikantët/kandidatët që i kanë kryer studimet në këtë universitet edhe pse përgjigjet e ENIC/NARIC të shteteve si Zvicra, Franca, Gjermania, Austria, Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë qenë negative.

Humbja e rasteve në gjykatë

Bazuar në vendimet gjyqësore të mësipërme dhe shqetësimet e Qendrës NARIC dhe Këshillit Shtetëror për Njohje, njëra ndër arsytet e humbjes së rasteve është edhe mungesa e Avokaturës së Shtetit në seanca gjyqësore në të cilat është e thirrur që të mbrojt institucionin, në këtë rast Ministrinë e Arsimit (MASH).

Rasti i fundit në të cilin Avokatura Shtetërore nuk ishte e pranishme në Gjykatë, sipas kryesueses së Këshillit Shtetëror për Njohje, Kumrije Gagica, ishte në tetor të vitit 2020, në rastin e një pale që ka paditur KShNj dhe NARIC-un për mosnjohje të diplomës.

Derisa kandidati që ka bërë padi në Gjykatë ishte me avokat, udhëheqësja e NARIC-ut njëherësh edhe kryesuese e KShNj-së, ishte pa mbrojtës ligjor nga zyra ligjore e Ministrisë së Arsimit apo Avokatura e Shtetit. Qendra NARIC duhet të përfaqësohet nga Avokatura e Shtetit dhe zyra ligjore e MASH, mirëpo bazuar në përvojat e mëhershme të mungesës së këtyre dy institucioneve në seanca, udhëheqësja e Qendrës kishte kërkuar autorizim me shkrim nga sekretari i përgjithshëm në MASH, për të qenë pjesë e kësaj seance.

Njohja e diplomës nga Komisioni i Ankesave dhe padia e KShNj-së ndaj tyre

Komisioni i Ankesave dhe zgjedhjes së kontesteve në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH), në vitin 2020 ka njohur një diplomë për të cilën Këshilli Shtetëror për Njohje (KShNj) kishte nxjerrë vendim negativ bazuar në përgjigjen zyrtare të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Shqipëri (MASR).

Në përgjigjen e MASR thuhej se në *“kolonën e diplomimit, nuk ka të dhëna për diplomën në fjalë”* dhe se *“MASR nuk është përgjegjëse për vërtetësinë e të dhënave të shënuara në formular”*.

KShNj pas njoftimit për njohje të kësaj diplome nga ana e Komisionit të Ankesave kishte njoftuar autoritetin më të lartë në MASH, Sekretarin e Përgjithshëm, Agim Bërdyna, si dhe ish-Ministren, Hykmete Bajrami, përmes të cilës ishte kërkuar që ky komision ta tërheqë këtë vendim.

Kërkesa ishte bazuar në Ligjin për Arsim të Lartë¹⁰, si dhe Udhëzimin Administrativ për parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës¹¹, në të cilët thuhet se vetëm KShNj është e thirrur për të bërë njohje të diplomave.

Këshilli Shtetëror për Njohje (KShNj) kishte pritur 29 ditë për tërheqje të këtij vendimi, por meqenëse ky komision nuk e kishte tërhequr këtë vendim, në emër të KShNj-së, Komisioni i Ankesave është paditur me 16 qershor të vitit 2020 dhe janë në pritje të një përgjigjeje nga gjykata.

Validimi i diplomave në NARIC KOSOVA

Sipas të dhënave të grumbulluara nga kjo qendër, sa i përket komponentës së validimit të diplomave të fituara brenda Kosovës me qëllim të përdorimit të tyre jashtë vendit, numri i aplikimeve është 70 për qind më i lartë se në vitet e kaluara, duke shënuar numrin prej 700 aplikimesh vetëm në muajin tetor të vitit 2020.

Qytetarët e Kosovës të cilët validojnë këto diploma, janë të kategorizuar në dy grupe nga qendra NARIC; ata të cilët shkojnë jashtë Kosovës për vazhdim të studimeve dhe ata të cilët shkojnë për punësim.

Sipas qendrës NARIC, ende nuk e kanë krijuar një rubrikë të veçantë në të cilën palët mund të deklarohen se për çfarë arsye po e bëjnë validimin, mirëpo sipas tyre, palët janë vetë-deklaruar për motivet e validimit të diplomës dhe kështu kanë ardhur në përfundim se rreth 30 për qind e tyre, shkojnë jashtë vendit për vazhdim të studimeve, ndërsa të tjerët apo rreth 70 për qind e tyre, e validojnë diplomën për të kërkuar një punë jashtë Kosovës.

¹⁰ Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2761>

¹¹ Udhëzimi Administrativ për parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, 2018, linku: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/09/ua-nr-12-2018-parimet-dhe-procedurat-e-njohjese-se-diplamave-gradave-dhe-kualifikimeve-te-shkollave-te-lart-profesionale-dhe-universitare-te-fituar-jashte-republikese-se-kosoves-x.pdf>

DEKLARATË E MOHIMIT TË PËRGJEGJËSISË:

Ky dokument është përpiluar me ndihmë financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim në kuadër të projektit “Cilësi, Llogaridhënie, Integritet dhe Transparencë në Arsimin e Lartë - QAINT”. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu, në asnjë mënyrë nuk mund ta pasqyrojnë mendimin zyrtar të Agjencisë Austriake për Zhvillim.

WITH FUNDING FROM
 AUSTRIAN
DEVELOPMENT
COOPERATION


Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministertva za Obrazovanje, Nauku i Tehnologji
Ministry of Education, Science and Technology

